

Emri: **Smajl**

Emri i babait: **Malush**

Mbiemri: **Latifi**

Ditëlindja: 09.10.1971

Vendlindja: Fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit.

Statusi shoqëror: I martuar me bashkëshorten Fatimen, me të cilën ka një djalë dhe një vajzë

Shkollimi

Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, të mesmen në Rahovec, ndërsa fakultetin në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, dega e Kimisë. Në të gjitha nivelet e shkollimit, shquhej për zgjuarsinë e tij dhe suksesin e tij shembullor.

Angazhimi në luftën çlirimtare

Angazhimin e tij për vendin e ka filluar në moshë shumë të re, duke marrë pjesë në organizimin e protestave kundër pushtuesit sllav, si nxënës i shkollës së mesme në Rahovec. Ndërkaq, përkitazi me rrethanat, është angazhuar në aktivitete kombëtare, të cilat i ka nisur në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), për të vazhduar më pas me organizime të ndryshme atdhetare. Ka qenë një ndër anëtarët e parë të organizatës politiko-ushtarake Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK). Ky angazhim, sigurisht se nuk i ka pëlqyer pushtuesit serb, i cili e ka burgosur për veprimtari atdhetare. Në kuadrin e këtij organizimi, është marrë me organizimin e formacioneve të para, fillimisht të LKÇK-së e më pas të UÇK-së në rajonin e Rahovecit dhe më gjerë. Ka qenë komandant kompanie në Anadrini e më pas komandant i batalionit të tretë të brigadës 124 “Gani Paçarizi” të UÇK-së. Në luftë për atdheun, është plagosur në fshatin Fortesë në betejën e korrikut të vitit 1998. Pas përfundimit të luftës ka vazhduar të merret me veprimtari atdhetare, duke mbështetur fuqishëm idenë e bashkimit të trojeve shqiptare, kudo ku pati nevojë për kontributin e tij.

Angazhimi Politik

Në legjislaturën e parë (2001-2004) ka qenë deputet i Kuvendit të Kosovës dhe bartës i përgjegjësive të ndryshme organizative në kuadër të LKÇK-së, kryetar i LKÇK-së e më pas kryetar i Lëvizjes për Integrim dhe Bashkim (LIB). Këtë pozitë e ka mbajtur deri në aderimin në radhët e AAK-së në gusht të vitit 2009. Kulm i karrierës së tij politike dhe periudha në të cilën ndjehet më së shumti krenar, është ajo sa ka qenë Kryetar i Komunës së Rahovecit (2010-2013). Pasi ka parë nevojën për ndryshime rrënjësore dhe gjendjen jo të kënaqshme të komunës që i takon,

ka vendosur që të angazohem dhe të jap kontributin e tij si kryetar komune. Vlerësime të shumta, këtë periudhë e kanë cilësuar si një nga më të suksesshme në histori të komunës, me investime dhe ndryshime të shumta të cilat kanë qenë të mirëpritura nga qytetarët. Gjatë kohës sa ka udhëhequr komunën, ka fituar një eksperiencë të jashtëzakonshme, ka kuptuar hallet dhe brengat e qytetarëve dhe ka qenë gjithmonë aty për ta. Me bekimin tuaj, Rahovecit ia kemi kthyer identitetin.

Z. Smajl Latifi shquhet për guxim e ndershmëri, drejtësi e humanizëm. Është i vendosur të çojë deri në fund fjalën e dhënë dhe i palëkundur në mbrojtje të interesave të përgjithshme. Aktualisht është kryetar i zgjedhur i komunës së Rahovecit, pasi mori besimin e qytetarëve.